



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

### RAPORT

nga

**Takimi i Kolegjjumit për Zyrtarë për Integritime Evropiane**

**Mitrovicë, 12 korrik 2011**

---

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

**Lënda:** Raport nga takimi i Kolegjjumit për Zyrtarë për Integritime Evropiane



## **HYRJE**

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për zyrtarë të integritimeve evropiane organizoi takimin e radhës së këtij Kolegjiut me 12 korrik maj 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorant „Ibri “ në Mitrovicë (Kushtove).

Takimi kishte për qëllim të diskutohet rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Plani i veprimit për riatdhesim
- Fuqizimi dhe përkrahja nga stafi politik komunal
- Koordinim i projekteve të BE-së së bashku me AZHR (takimi me ZNKE dhe AZHR)

Në këtë takim morën pjesë zyrtarë për integritime evropiane të Komunave të Kosovës, përfaqësues të AKK-së, si dhe përfaqësues të projektit të binjakëzimit të BE-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për zyrtarë të integritimeve evropiane, z. Shaqir Mala.

## **Përmbledhje**

Në takim u mirëprit vendimi për miratimin e rregullores së re për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarëve komunalë për integritim evropian me vendim nga Kryeministri me ç'rast do të sqarohet edhe pozita dhe përgjegjësitë e punës së zyrtarëve për integritime evropiane (ZIE) dhe do të shërbejë si një shtytje e mëtutjeshme për efektivitetin në punë.

Gjatë diskutimit për planin veprimit për riatdhesim u sqarua se zyrtarë për kthim dhe komunitete do të jenë përgjegjës ndërsa ZIE do të jenë bashkëpunëtor në këtë proces. Po ashtu u njoftua se komunat respektivisht ZIE duhet të adresojnë drejtpërdrejtë ministrisë kërkesat rreth çështjeve të objekteve për strehim për të riatdhesuarit apo rreth përgatitjes së projekteve për ndërtimin e objekteve për këta persona.

Gjatë vitit të kaluar të gjitha përgjigjet e Qeverisë për kërkesat e komunave për financim nga fondi qeveritar kanë qenë negative. Prandaj duhet të sqarohet mirë se cilat janë kushtet të cilat komunat duhen të plotësojnë për qasje në këto fonde - a duhet të lehtësohen procedurat e përfitimit të këtij fondi qeveritar? Me këtë rast u cek se duhet të ketë një koordinim më të mirë komunal sa i përket regjistrimit civil, arsimit dhe asistencës sociale.

Pengesë u konstatua edhe mungesa e bashkëpunimit në mes të ZIE dhe zyrtarëve për kthim të komuniteteve sepse nevojitet një bashkëpunim më i madh. Gjithashtu zyrat e aeroportit për njoftim dhe informim duhet tu tregojnë këtyre personave për të drejtat e tyre, për zyrat përkatëse në komunë dhe procedurat rreth shërbimeve të cilat mund t'i marrin. Zyrtarët u pajtuan po ashtu se duhet të ketë edhe një kampanjë televizive në nivel kombëtar për informimin e të drejtave, shërbimeve dhe adresën se ku mund t'i paraqesin kërkesat e tyre.

Në pjesën e dytë të takimit u diskutua për ndikimin që do të ketë rregullorja e re për ZIE në komuna, sfidën e madhe si dhe përgjegjësinë në zbatimin e detyrave të përcaktuara, po ashtu angazhimin serioz në realizimin e detyrave sa i përket përgatitjeve për integritim në BE. Një përgjegjësi shtesë do të jetë

edhe për Kryetarët e komunave në ecurinë e punëve sa i përket proceseve të mëtutjeshme të integriteteve. Me këtë rast duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me ZIE sa i përket realizimit dhe koordinimit të detyrave të përbashkëta në proceset e integriteteve evropiane.

Po ashtu u kërkua që versioni përfundimtar i rregullores të përcillet tek të gjithë zyrtarët përmes AKK-së.

Sa i përket bashkërendimit të projekteve të IPA-së Kryesuesi sqaroi se gjatë takimit me zyrtarë të KE-së një ndër temat është diskutuar edhe fuqizimi i rolit të këtyre zyrtarëve dhe koordinimi i projekteve të BE-së në nivel komunal në bashkëpunim me Agjencionet për Zhvillim Rajonal (AZHR). Një ndër përgjegjësitë pritet të jetë edhe koordinimi dhe raportimi për projektet e IPA-së në nivel komunal, dhe për këtë është i domosdoshëm një bashkëpunim më i ngushtë me AZHR-të. Njëra ndër kërkesat edhe nga vetë zyrtarët e AZHR është që komuna të ketë një person kontakt për njoftim të projekteve të tilla të cilat do të përfitonin komunat, e me këtë rast ZIE do të ishin personat më të përshtatshëm për koordinimin e punëve. Gjithashtu duhet të ketë një angazhim serioz të punës nga ZIE sa i përket përfitimit nga projektet e mundshme të BE-së.

#### **REKOMANDIMET:**

- Lehtësimi i procedurave sa i përket përfitimeve nga fondet qeveritare për personat e riadhesuar
- Funksionimi më i mirë i zyrave të informacionit në aeroport në varësi të MPB-ja sa i përket informimit të personave të riadhesuar
- Të zhvillohet një kampanjë televizive për informimin e të drejtave të personave të riadhesuar
- ZIE të jenë person kontakt në koordinimin e projekteve nga AZHR dhe investimeve të IPA-së
- Zbatimi sa më i shpejtë i rregullores për ZIE nga komunat
- AKK të shpërndajë versionin përfundimtarë të rregullores tek të gjitha komunat